




Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
Uprava za Urbanizam, Planiranje i Zastitu Okoline
Department for Urbanism, Planning and Environmental Protection

PLANI VJETOR I PUNËS 2026



**DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË
MJEDISIT**

Dhjetor 2025

HYRJA

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, ka hartuar planin vjetor të punës duke u bazuar në prioritet strategjike dhe të nevojave të adresuar nga qytetarët e komunës sonë. Duke u bazuar edhe në përvojën e viteve të kaluar, plani vjetor i punës për vitin 2026 është hartuar me kujdes të veçantë, në mënyrë që të jetë i kompletuar në aspektin e zbatimit dhe përmbushjes së vizionit të qeverisë komunale. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, vitin 2024, do vazhdojë me të njejtin organizim sectorial: Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

PËRKUSHTIM I VEÇANT I DREJTORISË PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Përkushtim i veçant i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit do të jetë:

- * Miratimi i Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit;
- * Rregullimi i sheshit qendror të qytetit;
- * Ndërtimi i Ballkonit Panoramik mbi qytetin e Rahovecit.

OBJEKTIVAT KRYESORE TË DREJTORISË PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

- * Realizimi i plotë i listës së projekteve kapitale për vitin 2026;
- * Përfundimi dhe miratimi në Kuvendin Komunal i Hartës Zonale të Komunës;
- * Vazhdimi i implementimit të ligjit për legalizimin e objekteve pa leje ndërtimore;
- * Hartimi i projekteve të reja në bashkëpunim me kompani profesionale të projektimit;
- * Krijimi i hapësirave gjelbëruese;
- * Dhënia e përgjigjeve për të gjitha llojet e kërkesave të personave fizikë dhe juridikë;
- * Fasadimi i objekteve kolektive.

PLANIFIKIMI SIPAS TREMUJJORËVE

Tremujori I

- * Shqyrtimi i të gjitha kërkesave të qytetarëve brenda afatit minimal ligjor (leje ndërtimore, leje rrënimi, kushte ndërtimore, leje mjedisore komunale, vërtetime urbanistike, certifikata përdorimi).
- * Rritja e të hyrave vetanake përmes lëshimit të lejeve ndërtimore, lejeve mjedisore komunale dhe legalizimit të objekteve pa leje.
- * Miratimi i Hartës Zonale të Komunës si dokument strategjik hapësinor.
- * Përgatitjet për fillimin e punimeve në projekte kapitale.
- * Shënimi i Ditës Botërore të Ujit.

Tremujori II

- * Shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve sipas afatit ligjor.
- * Mbikëqyrja e projekteve kapitale për cilësinë e punimeve dhe realizimin e tyre sipas projekteve.
- * Shënimi i Ditës së Tokës (22 Prill).
- * Shënimi i Ditës Botërore të Mjedisit (5 Qershor).

Tremujori III

- * Shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve sipas afatit ligjor.
- * Mbikëqyrja e projekteve kapitale për cilësinë e punimeve dhe realizimin e tyre sipas projekteve.

Tremujori IV

- * Menaxhimi sa më efektiv i projekteve kapitale të drejtuara nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bashkëpunim me organin mbikëqyrës të punimeve.
- * Prioritet: realizimi i buxhetit dhe projekteve të planifikuara për vitin 2026.